

LIGJ
Nr. 78/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË MOLDAVISË PËR BASHKËPUNIMIN POLICOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Moldavisë për bashkëpunimin policor sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 278, datë 31.7.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MOLDAVISË MBI BASHKËPUNIMIN POLICOR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Moldavisë, në tekstin e mëposhtëm referuar si Palët Kontraktuese,

të vetëdijshëm për kërcënimin në rritje të krimit të organizuar ndërkufitar;

duke njohur rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e trajtimit të krimit ndërkufitar;

qeverisur nga Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (në tekstin e mëtejme: Konventa), nënshkruar në Vjenë më 5 maj 2006, ratifikuar nga ligji nr. 5/2008 i Parlamentit të Republikës së Moldavisë dhe ratifikuar në Republikën e Shqipërisë më 11 shtator 2006;

në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve, në lidhje me Përpunimin Automatik ose të Dhënave Personale (ETS nr. 108), nënshkruar nga Republika e Moldavisë më 4 maj 1998 dhe ratifikuar nga ligji i parlamentit nr. 483-XIV/1999, nënshkruar nga Republika e Shqipërisë dhe ratifikuar me ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004;

duke marrë parasysh dispozitat e konventave të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës në fushën e luftës kundër formave të ndryshme të krimit, veçanërisht Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar të vitit 2000;

duke shprehur interesin e përbashkët në marrjen e masave të dobishme për të luftuar krimin ndërkufitar si dhe vepra të tjera penale,

me synimin për të zhvilluar bashkëpunim në fushën e veprimtarive policore;

duke respektuar ligjin kombëtar të të dyja Palëve Kontraktuese dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme për të dyja Palët Kontraktuese;

duke vepruar brenda kuadrit të kompetencës së tyre dhe duke iu nënshtruar akteve ligjore të zbatueshme për Palët Kontraktuese, kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Objektivat dhe parimet e bashkëpunimit

1. Sipas kësaj Marrëveshjeje (referuar më poshtë si Marrëveshje) Palët Kontraktuese do të kërkojnë të luftojnë krimin në mënyrë më efektive.

2. Në përputhje me kompetencat e tyre, Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë brenda fushës së kësaj Marrëveshjeje, duke respektuar normat përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare detyruese të zbatueshme për shtetin e Palëve Kontraktuese.

3. Me qëllim forcimin e marrëdhënies së tyre bilaterale, Palët Kontraktuese marrin përsipër të zhvillojnë një dialog gjithëpërfshirës dhe të promovojnë bashkëpunimin e mëtejshëm, ndërmjet tyre për të gjithë sektorët me interes të përbashkët, siç parashikohet në këtë Marrëveshje.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

1. Palët Kontraktuese marrin përsipër t'i japin njëra-tjetrës, në përputhje me rregulloret dhe kushtet e vendosura në këtë Marrëveshje, bashkëpunimin më të gjerë të mundshëm në fushën e veprimtarive policore.

2. Bashkëpunimi i Palëve Kontraktuese, i kryer brenda fushës së kësaj Marrëveshjeje, zbatohet në fushat e mëposhtme:

- a) veprat penale në lidhje me krimin ndërkufitar në lëvizje;
 - b) veprat penale në lidhje me krimet kundër jetës, shëndetit dhe integritetit fizik të personit;
 - c) veprat penale në lidhje me prodhimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike;
 - d) sigurimi, trafikimi i qenieve njerëzore dhe shfrytëzimi seksual i fëmijëve;
 - e) vepra penale në fushën e mashtrimit;
 - f) vjedhja dhe trafikimi i paligjshëm i armëve të zjarrit, municioneve, eksplozivëve, substancave radioaktive, lëndëve bërthamore dhe substancave të tjera të rrezikshme;
 - g) krimet e pronës;
 - h) falsifikimi i dokumenteve zyrtare;
 - i) krimet ekonomike dhe financiare;
 - j) vepra penale kundër vlerave kulturore;
 - k) vjedhja, rrëmbimi dhe tregtia e paligjshme e automjeteve dhe identifikimi i dokumenteve të falsifikuara;
 - l) pastrimi i parave;
 - m) krim kibernetik;
 - n) veprat penale në fushën kundër terrorizmit dhe financimit të tij.
3. Me marrëveshje të ndërsjellë, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të ndihmojnë njëra-tjetrën në luftën kundër krimeve të tjera të mbuluara nga ligji kombëtar i Palëve Kontraktuese.
4. Kjo Marrëveshje nuk përfshin dispozitat për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështje penale ose ekstradim.

Neni 3

Fushat shitesë të bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve Kontraktuese do të shtrihet, gjithashtu, edhe mbi fushat e mëposhtme shitesë të bashkëpunimit:

- a) kërkimin e njerëzve të zhdukur dhe asistimin në identifikimin e kufomave të paidentifikuara;
- b) kërkimin e territorit të një Pale Kontraktuese për objekte të vjedhura, të zhdukura, të përvetësuara ose të humbura në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 4

Format e bashkëpunimit

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në fushat e referuara në nenet 2 dhe 3, në format e mëposhtme:

- a) shkëmbimi i informacionit në lidhje me veprat penale;
- b) ndihma e ndërsjellë në zbatimin e masave për luftën kundër krimit;
- c) takimet e punës për të përgatitur koordinimin dhe kryerjen e masave në lidhje me zbulimin e krimit;
- d) shkëmbimi i informacionit mbi kërkesat e akteve ligjore të zbatueshme për Palët Kontraktuese, informacioni statistikor në lidhje me zonat e krimit kombëtar të Palëve Kontraktuese, si dhe informacione të tjera mbi metodat e reja në luftën kundër krimit në përgjithësi;
- e) sigurimi i ndihmës në trajnimin profesional të oficerëve të policisë dhe përmirësimi i aftësive profesionale;
- f) ndihma kriminalistike, metodologjike dhe teknike;
- g) zbatimi i kërkimeve të përbashkëta shkencore bazuar në interesa të përbashkët, duke u përqendruar kështu në zgjidhjen e problemeve që lidhen me luftën kundër krimit;
- h) analiza e riskut dhe tendencat e krimit;
- i) identifikimi i automjeteve të vjedhura;
- j) mbrojtja e dëshmitarit;
- k) identifikimi i fondeve të nevojshme për të promovuar projekte të përbashkëta të ndihmës, duke siguruar grante dhe donacione për zhvillimin e forcave të policisë;
- l) organizimi i ushtrimeve, konkurseve dhe garave të përbashkëta policore.

Neni 5

Shkëmbimi i informacionit

1. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet Palëve Kontraktuese duhet të kryhet për qëllim të ose në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Transmetimi i të dhënave personale dhe informacioneve të tjera nga Palët Kontraktuese duhet të jetë i domosdoshëm, sipas kërkesës, me qëllim parandalimin ose luftimin e veprave penale.

3. Palët Kontraktuese do të sigurojnë vetëm informacione për njëra-tjetrën, i cili është mbledhur, ruajtur dhe transmetuar, në përputhje me kuadrin e tyre përkatës ligjor dhe nuk është në shkelje të të drejtave të njeriut.

4. Pala Kontraktuese që ka transmetuar të dhëna, duhet të sigurojë që këto të dhëna të jenë të sakta dhe kur është e nevojshme të përditësuara dhe që përmbajtja e tyre t'i shërbejë qëllimit të kërkuar. Nëse konstatohet që janë transmetuar të dhëna të pasakta ose të dhëna që nuk duhet të ishin transmetuar, atëherë, pa humbur kohë, duhet njoftuar pala marrëse. Palët Kontraktuese duhet të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhëna të pasakta, në lidhje me qëllimin për të cilin janë përpunuar.

5. Të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen për aq kohë, por jo më tepër sa është e nevojshme, për qëllimin për të cilin janë transmetuar.

Neni 6

Kërkesa për asistencë

1. Asistenca do të sigurohet sipas kësaj Marrëveshjeje, në rast se njëra nga Palët Kontraktuese paraqet një kërkesë për ndihmë ose nën iniciativën e njëres nga Palët Kontraktuese, e cila gjykon se ndihma përputhet me interesat e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Kërkesa për dhënien e ndihmës dhe përgjigjet e këtyre kërkesave duhet të paraqiten në formë të shkruar përmes organeve qendrore të secilës Palë Kontraktuese përgjegjëse për bashkëpunimin policor ndërkombëtar. Ndërsa kërkesa nuk mund të dërgohet në terma të përshtatshëm, duke përdorur procedurën e mësipërme, autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese, përjashtimisht dhe vetëm në rast urgjence, mund t'ia drejtojnë atë drejtpërdrejtë autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese të kërkuar, të cilat mund të përgjigjen drejtpërdrejt. Në këto raste të jashtëzakonshme,

autoriteti kërkues duhet që në rastin më të shpejtë, të informojë organin qendror përgjegjës për bashkëpunimin policor ndërkombëtar në Palën Kontraktuese të kërkuar për kërkesën e tij të drejtpërdrejtë që motivon urgjencën e kësaj të fundit.

3. Kërkesat për dhënien e ndihmës nënshkruhen nga krerët e Palëve Kontraktuese ose ndonjë udhëheqës tjetër i caktuar.

4. Kërkesa për dhënien e ndihmës, e përshkruar në paragrafin 1, duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- a) titulli dhe emri i autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese kërkuese;
- b) titulli dhe emri i autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese të kërkuar;
- c) përmbajtja dhe arsytimi i kërkesës për dhënien e ndihmës;
- d) informacioni i hollësishëm mbi rastin, në lidhje me të cilin është bërë kërkesa për dhënien e ndihmës;
- e) veprimet konkrete të cilat kërkohen të kryhen, përshkrimi dhe arsytimi i tyre;
- f) respektimi i afateve kohore për të cilat pritet një përgjigje për kërkesën mbi dhënien e asistencës, kur është e aplikueshme;

g) informacion tjetër i nevojshëm për zbatimin e kërkesës për dhënien e ndihmës;

5. Në rast se kërkesa për dhënien e ndihmës ose përgjigja nuk përputhet me kërkesat e lartpërmendura, Palët Kontraktuese mund të kërkojnë të plotësojnë informacionin e dhënë.

6. Përmes dispozitave të Marrëveshjes, Palët Kontraktuese mund t'i ofrojnë ndihmë njëra-tjetrës me iniciativën e tyre.

Neni 7

Zbatimi i kërkesave për ndihmë

1. Pala Kontraktuese e kërkuar ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e shpejtë të kërkesës për dhënien e ndihmës.

2. Zbatimi i kërkesës së paraqitur për dhënien e ndihmës mund të mohohet, në rast se vepra penale, në lidhje me të cilën është paraqitur kërkesa e dhënies së ndihmës, nuk është në përputhje me aktet ligjore të zbatueshme nga Pala Kontraktuese e kërkuar.

Neni 8

Arsimimi dhe trajnimi

Palët Kontraktuese kryejnë veprimet e mëposhtme, për të kryer aktivitete bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe trajnimit të personelit të zbatimit të ligjit:

- a) vizita në njësi, seli dhe institucione;
- b) sigurimi i trajnimit reciprok, arsimit dhe kurseve në shkolla, akademi, qendra trajnimi dhe njësi të Palëve Kontraktuese;
- c) informacion, përvojë dhe bashkëpunim teknologjik në sigurinë publike;
- d) trajnim dhe praktikë në detyrë që do të sigurohet në njësitë, selinë dhe institucionet e të dyja Palëve Kontraktuese;
- e) shkëmbimi i informacioneve dhe eksperiencave mbi subjektet dhe projektet e përbashkëta;
- f) programe të shkëmbimit të konvertimit profesional;
- g) programet "trajno trajnerin".

Neni 9

Shkenca mjekoligjore

1. Palët Kontraktuese rrisin bashkëpunimin në fushën e shkencës mjekoligjore në format e mëposhtme

- a) zbatimi i projekteve të përbashkëta kërkimore, shkëmbimi i rezultateve të tyre, si dhe kërkuesit shkencorë dhe ekspertët që marrin pjesë në këto projekte;
- b) shkëmbimi i personelit për të marrë pjesë në konferenca të përbashkëta, seminare, simpoziume, ekspozita dhe aktivitete të tjera;
- c) shkëmbimi i informacionit mbi materialet edukative dhe metodike;

- d) shkëmbimi i programeve të trajnimit për ekspertët mjekoligjorë;
 - e) bursa në institucionet e trajnimit të policisë;
2. Ndërsa bashkëpunojnë në fushën e shkencës mjekoligjore, Palët Kontraktuese marrin përsipër të:
- a) japin ndihmën e nevojshme shkencore-metodologjike dhe praktike në përgatitjen e botimeve të përbashkëta shkencore dhe speciale;
 - b) japin konsulta dypalëshe për bashkëpunimin shkencor;
 - c) japin ndihmë të ndërsjellë në kryerjen e ekspertizës gjenetike mjekoligjore, në identifikimin dhe marrjen e mostrave të gjurmëve biologjike njerëzore të lëna në skenën e krimit;
 - d) mbështesin përpjekjet e personelit në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta;
 - e) zbatimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë;
 - f) ndihmojnë njëra-tjetrën në organizimin e shkëmbimeve të ndërsjella të synuara dhe trajnimin e personelit në mënyrë që të zhvillojnë kërkime të përbashkëta;
 - g) shkëmbimi i materialeve trajnuese.

Neni 10

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Palët Kontraktuese do të sigurojnë një nivel të mbrojtjes së të dhënave personale të transmetuara nga një Palë tjetër Kontraktuese, ekuivalent të paktën me atë që rezulton nga zbatimin e parimeve të Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve, në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (CETS nr. 108), duke përfshirë ndryshimet.

2. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë të dhëna personale ekskluzivisht brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje dhe do t'i përdorin ato në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, detyrimet ndërkombëtare të Palëve Kontraktuese dhe rregulloret e tyre të brendshme, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 11

Konfidencialiteti

1. Palët Kontraktuese sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të marrë nga njëra-tjetra në përputhje me Marrëveshjen, detyrimet ndërkombëtare të ndërmarra nga vendi i tyre dhe në përputhje me aktet ligjore të zbatueshme për to.

2. Pala Kontraktuese kërkuar do të përdorë informacionin vetëm për qëllimet, të cilat tregohen në kërkesën për sigurimin e informacionit. Miratimi paraprak me shkrim duhet t'i merret përpara Palës Kontraktuese të kërkuar, në rast se Pala tjetër Kontraktuese është e gatshme të përdorë informacionin për qëllime të tjera ose transferimin e informacionit te personat e tretë.

3. Palët Kontraktuese, të cilat shkëmbejnë këto të dhëna, janë të detyruara që të dhënat personale, të cilat janë transmetuar, të mbrohen nga aksesit i paautorizuar, ndryshimet dhe publikimet e paautorizuara.

Neni 12

Mënyra të tjera të bashkëpunimit

1. Palët Kontraktuese bien dakord t'i japin njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë në fushën e formimit profesional dhe ndihmës teknike për problemet që lidhen me funksionimin e policisë.

2. Palët Kontraktuese bien dakord të shkëmbejnë përvojat e tyre praktike në të gjitha fushat e trajtuara në këtë Marrëveshje.

Neni 13

Konsultimet

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, mund të krijojnë grupe pune të përhershme ose *ad-hoc*, në mënyrë që të shqyrtojnë problematikat e ndërsjella, në lidhje me zbulimin dhe parandalimin e zonave të krimit të përmendura në nenin 2 dhe në nenin 3, dhe nëse gjykohet e nevojshme, për të bërë propozime për përmirësimin e aspekteve praktike dhe teknike të bashkëpunimit ndërmjet palëve kontraktuese.

2. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të krijojnë një komitet vlerësimi, i cili do të raportojë në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje deri në fund të vitit ose sipas kërkesës.

Neni 14

Autoritetet kompetente

Për qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të realizohet bashkëpunim nëpërmjet autoriteteve të mëposhtme:

1. Autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë, në veçanti Ministria e Brendshme, përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit shqiptar.

2. Autoritetet kompetente të Qeverisë së Republikës së Moldavisë, në veçanti Ministria e Punëve të Brendshme, përmes Inspektoratit të Përgjithshëm të Policisë.

Neni 15

Kontaktet

1. Palët Kontraktuese do të komunikojnë me njëra-tjetrën përmes kanaleve diplomatike, emrat e departamenteve të tyre përkatëse të autorizuar për të zbatuar këtë Marrëveshje, duke treguar adresën, numrat e telefonit, postat elektronike ose detaje të tjera të kontaktit, brenda tridhjetë ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoritetet kompetente do të informojnë njëra-tjetrën menjëherë ose për rastet të ndryshimit të detajeve, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 16

Gjuha

Palët Kontraktuese do të përdorin gjuhët e tyre zyrtare, me kusht që të paraqitet, gjithashtu, një përkthim në gjuhën zyrtare të Palës tjetër Kontraktuese ose në gjuhën angleze, ndërsa bashkëpunojnë brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Shpenzimet

1. Secila palë kontraktuese do të mbulojë shpenzimet, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në këtë marrëveshje, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe.

2. Vizitat e përfaqësuesve të Palës Kontraktuese kërkuese do të jenë të kushtëzuara, në rast se ka një pëlqim paraprak të marrë nga Pala Kontraktuese e kërkuar.

Neni 18

Hyrja në fuqi, ndryshimi dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes, përmes kanaleve diplomatike, të njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën në lidhje me përmbushjen e të gjitha procedurave të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të saj.

2. Palët Kontraktuese mund të bien dakord për nënshkrimin e planeve të veprimit për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

3. Kjo Marrëveshje do të lidhet për një kohë të pacaktuar. Secila Palë Kontraktuese mund ta përfundojë këtë Marrëveshje, duke i dhënë Palës tjetër Kontraktuese një njoftim me shkrim përmes kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi pas 6 (gjashtë) muajsh nga data e marrjes së njoftimit me shkrim me të cilin një Palë Kontraktuese informon Palën tjetër Kontraktuese për qëllimin e saj për të përfunduar këtë Marrëveshje.

4. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe aneksohet mbi bazë të pëlqimit të përbashkët me shkrim të Palëve. Ndryshimet dhe shtesat do të hyjnë në fuqi sipas procedurës parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

5. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me anë të negociatave dhe konsultimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese.

Nënshkruar në Moldavi, më 16.11.2023, në dy kopje origjinale; secila në gjuhët shqipe, rumune dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë identike dhe në përputhshmëri të plotë. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës së Moldavisë

AGREEMENT

BETWEEN

THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

AND

**THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF MOLDOVA
ON POLICE COOPERATION**

The Council of Ministers of the Republic of Albania and The Government of the Republic of Moldova, hereinafter referred to as the Contracting Parties,

aware of the growing threat of the organized cross-border criminality,

recognizing the importance of international cooperation in the field of tackling cross-border criminality,

governed by the Police Cooperation Convention for Southeast Europe (hereinafter: Convention), signed in Vienna on 05 May 2006, ratified by Republic of Moldova Parliament's Law no 5/2008 and ratified by the Republic of Albania on 11 September 2006,

in compliance with the Council of Europe Convention for the Protection of Individuals with regard to Automatic Processing of Personal Data (ETS No.108), signed by Republic of Moldova on 04 May 1998 and ratified by the Parliament's Law no 483-XIV/1999, signed by the Republic of Albania and ratified by Law no. 9288, on 7.10.2004,

taking into consideration the provisions of the Conventions of the United Nations and the Council of Europe in the area of fight against various forms of crime in particular the United Nations Convention against Transnational Organized Crime of 2000,

expressing the mutual interest in taking mutually beneficial measures to combat cross-border criminality and other criminal offences,

with the intention to develop cooperation in the field of police activities,

paying respect to the national law of both Contracting Parties and the international Agreements applicable to both Contracting Parties,

acting within the framework of their competence and subject to legal acts applicable to the Contracting Parties,

have agreed on the following:

Article 1

Objectives and principles of cooperation

1. Following this Agreement (hereinafter: Agreement) the Contracting Parties shall seek combating crime more efficiently.
2. In accordance with their competences, the Contracting Parties shall cooperate within the scope of this Agreement while respecting the relevant national and international binding norms applicable to the state of the Contracting Parties.
3. With a view to strengthening their bilateral relationship, the Contracting Parties undertake to hold a comprehensive dialogue and promote further cooperation between them on all sectors of mutual interest as provided under this Agreement.

Article 2

Areas of cooperation

1. The Contracting Parties undertake to grant each other, in compliance with the regulations and the conditions established under this Agreement, the widest cooperation possible in the field of police activities.
2. The cooperation between the Contracting Parties conducted within the scope of this Agreement is implemented in the following areas:
 - a) offences related to cross-border to be excluded criminality;
 - b) offences against a person's life, health and physical integrity;
 - c) offences related to manufacturing and trafficking of narcotics;
 - d) procuring, trafficking in human beings and sexual exploitation of children;
 - e) the criminal offence in the field of fraud;
 - f) theft and illicit trafficking in arms and weapons, ammunition, explosives, radioactive substances, nuclear material and other dangerous substances;
 - g) property crimes;
 - h) forgery of official documents;
 - i) economic and financial crimes;
 - j) offences against cultural goods;
 - k) theft, hijacking and illicit trade in motor vehicles and identifying forged vehicles documents;

- l) money laundering;
- m)cybercrime;
- n) offences for terrorist purposes and financing of terrorism.

3. By mutual agreement, the competent authorities of the Contracting Parties will assist each other in combating other crimes covered by the national law of the Contracting Parties.

4. This Agreement does not cover provisions for mutual legal assistance in criminal matters or extradition.

Article 3

Additional areas of cooperation

The cooperation between the Contracting Parties shall also extend over the following additional areas:

- a) searching missing people and assisting the identification of unidentified corpses;
- b) searching the territory of one Contracting Party for objects stolen, missing, embezzled or lost on the territory of the other Contracting Party.

Article 4

Forms of cooperation

The Contracting Parties shall cooperate in the areas referred to in articles 2 and 3 under the following forms:

- a) exchanging information related to criminal offences;
- b) mutual assistance in implementing measures on combating crime;
- c) working meetings to prepare, coordinate and conduct measures related to detection of crime;
- d) exchange of information on the requirements of legal acts applicable to the Contracting Parties, statistical information concerning national crime areas of the Contracting Parties, as well as other information upon new methods in combating crime overall;
- e) providing assistance in professional training of police officers and improving professional skills;

- f) forensic, methodological and technical assistance;
- g) implementing joint scientific researches based on mutual interests, thus focusing on solving the problems associated with combating crime;
- h) risk analysis and crime trends;
- i) identifying stolen vehicles;
- j) witness protection;
- k) identification of necessary funds in order to promote common assistance projects, providing grants and donations for the development of police forces;
- l) organizing joint police exercises, competitions and contests.

Article 5

Exchange of information

1. Exchange of information between the Contracting Parties shall only take place for the purpose of and in accordance with the provisions of this Agreement.
2. The transmission of personal data and other information by the Contracting Parties must be necessary upon request for the purpose of preventing or combating the criminal offences.
3. The Contracting Parties shall only supply information to each other which was collected, stored and transmitted in accordance with their respective legal framework and has not been manifestly obtained in violation of human rights.
4. The Contracting Party that transmitted the data must ensure that this data is accurate and, when necessary, updated and that its content serves the intended purpose. If it is found that inaccurate data or data that should not have been transmitted have been transmitted, then the receiving party must be notified immediately. The Contracting Parties shall take all reasonable steps to delete or correct inaccurate data concerning the purpose for which they were processed.
5. The transmitted personal data must be stored for as long as possible, but not longer than necessary for the purpose for which they were transmitted.

Article 6

Requests for assistance

1. The assistance shall be provided under this Agreement, in case one of the Contracting Parties submits a request for assistance or under the initiative of one of the Contracting Parties, which deems the assistance complying with the interests of the other Contracting Party.

2. The request on providing assistance and the replies to these requests should be submitted in written form through the central bodies of each Contracting Party responsible for international police cooperation. Whereas the request cannot be sent in appropriate terms using the above procedure, the competent authorities of the requesting Contracting Party may, exceptionally and in case of urgency only, address it directly to the competent authorities of the requested Contracting Party, which may reply directly. In these exceptional cases, the requesting authority must at the earliest opportunity inform the central body responsible for international police cooperation in the requested Contracting Party of its direct request motivating the urgency of the latter.

3. The requests on providing assistance are signed by the heads of the **competent authorities** of the Contracting Parties or any other designated leader.

4. The request on providing assistance, described in Paragraph 1, shall contain the following information:

- a) title and name of the requesting **the competent authorities** of the Contracting Party;
- b) title and name of the requested **the competent authorities** of the Contracting Party;
- c) the content and reasoning of the request on providing assistance;
- d) detailed information on the case, with regard to which the request on providing assistance was made;
- e) concrete actions which are requested to be performed, their description and reasoning;
- f) time limits, respecting which it is expected to receive the reply to the request on providing assistance, when applicable;
- g) other information necessary for implementing the request on providing assistance.

5. In case the request on providing assistance or the reply does not comply with the above-mentioned requirements, the Contracting Parties may request to supplement the provided information.

6. Through the provisions of the Agreement, the Contracting Parties may also provide each other with information on their own initiative.

Article 7

Implementation of requests for assistance

1. The requested Contracting Party undertakes all the necessary measures in order to ensure prompt implementation of the request on providing assistance.

2. The implementation of the submitted request on providing assistance may be denied, in case that the criminal offence, concerning which the request of providing assistance was submitted, does not fall under criminal prosecution in accordance with the legal acts applicable by the requested Contracting Party.

Article 8

Education and training

The Contracting Parties carry out the following actions in order to carry out cooperation activities in the field of education and training of law enforcement personnel:

- a) visits to units, headquarters and institutions;
- b) ensuring reciprocal training, education and courses at schools, academies, training centers and units of the Contracting Parties;
- c) information, experience and technological cooperation in public security;
- d) on-duty training and internship that shall be provided at the units, headquarters and institutions of both Contracting Parties;
- e) experience and information exchange on common subjects and projects;
- f) exchange of professional conversion programs;
- g) train the trainer programs.

Article 9

Forensic science

1. The Contracting Parties enhance cooperation in the field of forensic science in the following forms:

- a) implementation of joint research projects, exchange of their results, as well as scientists and experts who participate in these projects;
- b) exchange of personnel to participate in joint conferences, seminars, symposia, exhibitions and other events;
- c) exchange of information on educational and methodical materials;
- d) exchange of training programs for forensic experts;
- e) scholarship at the police training institutions.

3. While cooperating in the field of forensic science the Contracting Parties undertake to:

- a) provide the necessary scientific-methodological and practical assistance in the preparation of joint publications in scientific and special editions;
- b) provide bilateral consultations on scientific cooperation;
- c) provide mutual assistance in carrying out the forensic genetic expertise, in identifying and sampling the biological human traces left at serious crimes scene;
- d) support the efforts of personnel in the preparation and implementation of joint projects;
- e) implement the quality management system;
- f) assist each other in the organization of targeted mutual exchanges and training of personnel in order to develop joint researches;
- g) exchange of training materials.

Article 10 **Protection of personal data**

1. The Contracting Parties shall ensure a level of protection of personal data transmitted by another Contracting Party, equivalent at least to that resulting from the application of the principles of the Council of Europe Convention for the Protection of Individuals with regard to Automatic Processing of Personal Data (CETS No. 108), including the amendments.

2. The Contracting Parties shall exchange personal data exclusively within the framework of this Agreement and shall use them in accordance with the provisions of this Agreement, the international obligations of the Contracting Parties and their domestic regulations regarding the protection of personal data.

Article 11 **Confidentiality**

1. The Contracting Parties ensure confidentiality of the information received from each other in accordance with the Agreement, the international obligations undertaken by their country and in line with legal acts applicable to them.

2. The requesting Contracting Party shall use the information only for the purposes, which are indicated in the request on providing information. Prior written consent must be acquired from the requested Contracting Party, in case the other Contracting Party is willing to use the information for other purposes or transfer the information to third persons.

3. The Contracting Parties that exchange this data shall be obliged to protect the personal data, which have been transmitted, from the unauthorized access, changes and unauthorized disclosure.

Article 12

Other forms of cooperation

1. The Contracting Parties agree to grant each other mutual aid in the field of vocational training and technical aid for the problems related to the functioning of the police.
2. The Contracting Parties agree to exchange their practical experiences in all the fields tackled in this Agreement.

Article 13

Consultations

1. The competent authorities of the Contracting Parties may set up permanent or *ad-hoc* working groups in order to examine mutual problems related to the detection and prevention of crime areas mentioned in Article 2 and Article 3 and, if deemed necessary, to make proposals for enhancing practical and technical aspects of the cooperation between the Contracting Parties.
2. The competent authorities of the Contracting Parties shall create an evaluation committee, which shall report about the implementation of this Agreement by the end of the year or upon request.

Article 14

Competent authorities

For the purpose of implementing this Agreement, cooperation shall be realized through the following authorities:

- The competent authorities of the Government of the Republic of Moldova, in particular the Ministry of Internal Affairs through the General Police Inspectorate;
- The competent authorities of the Council of Ministers of the Republic of Albania, in particular the Ministry of Interior through the General Directorate of Albanian State Police.

Article 15

Contact details

1. The Contracting Parties shall communicate each other through diplomatic channels the names of their respective departments empowered to implement this Agreement, indicating the address, telephone numbers, emails or other contact details, within thirty days from the date of entry into force of this Agreement.
2. The competent authorities shall inform each other immediately or upon cases of changing the details communicated pursuant to paragraph 1 of this Article.

Article 16
Language

The Contracting Parties shall use their official languages, provided that a translation into the official language of the other Contracting Party or into English language is also submitted along, while cooperating within the framework of this Agreement.

Article 17
Costs

1. Each Contracting Party shall cover the expenses, related to the fulfillment of the obligations provided for in this Agreement, unless agreed otherwise.

2. The visits of the representatives of the requesting Contracting Party shall be contingent, in case there is a prior written consent received from the requested Contracting Party.

Article 18
Entry into Force, Amendment and Termination

1. This Agreement shall enter into force on the date of receiving, through diplomatic channels, the last written notification by which the Contracting Parties inform each other about the fulfillment of all the internal legal procedures required for its entry into force.

2. The Contracting Parties may agree on the signing of action plans on the implementation of this Agreement.

3. This Agreement shall be concluded for an indefinite period of time. Each Contracting Party may terminate this Agreement by giving the other Contracting Party a written notification through diplomatic channels. The Agreement shall cease to be effective after six (6) months from the date of receipt of a written notification by which one Contracting Party informs the other Contracting Party of its intention to terminate this Agreement.


4. This Agreement might be amended and annexed by mutual consent of the Contracting Parties. Amendments and additions shall enter into force pursuant with the procedure provided for in paragraph (1) of this Article.

5. Any disputes concerning the interpretation and application of this Agreement shall be settled by way of negotiations and consultations between the Contracting Parties.

DONE at MOLDOVA, on 16/11/2023 in two originals each in the Albanian, Romanian, and English languages, all texts being equally valid. In the case of divergence in the interpretation of this Agreement, the English text shall prevail.

For the Council of Ministers

of the Republic of Albania



For the Government

of the Republic of Moldova

